

**INSTITUTI PËR AKTIVIZËM DHE NDRYSHIM SOCIAL**

*dhe*

**DREJTORISË SË PËRGJITSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS**

*ndërmjet*

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Nr. 193/2 Prot  
Tiranë, më 8 / 2 / 2024

Nr. 300 Prot  
Tiranë, më 08 / 02 / 2024

**INSTITUTI PËR AKTIVIZËM  
DHE NDRYSHIM SOCIAL**



**DREJTORIA E PËRGJITSHME  
E SHËRBIMIT TË PROVËS  
MINISTRIA E DREJTËSISË**

**SHËRBIMI I PROVËS**



Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

**Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Proves** në Republikën e Shqipërisë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë me adresë Rruga "Jordan Misiq", Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Klevis Qose**, në vijim e cilësuar si "DPSHP";

**Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social** (organizatë joqeveritare, jopartiake dhe jopolitike, e themeluar në vitin 2018 dhe e regjistruar zyrtarisht me Vendimin e Gjykatës nr.6150, datë 31.01.2019, me adresë Rruga "Islam Alla" Pallati 72, Ap. 7, me numrin tatumor L91420451, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Zj. Erinda Billaca Ndroqi**, në vijim cilësuar si "IANS").

### Neni 1

#### Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të sigurojë një kornizë bashkëpunimi dhe të rregullojë dhe forcojë bashkëpunimin institucional midis Shërbimit të Proves dhe IANS në kuadër të konsolidimit të gasjeve rehabilituese dhe reintegruese për të kthyerit nga zonat e konfliktit, që klasifikohen për denime alternative apo denime plotësuese apo masa shtrënguese, në zbatim të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë, duke përfutur nga zbatimi i aktiviteteve të Projektit në përpunje me qëllimin e përgjithshëm të tij dhe objektivat specifike të specifikuara në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshje.

### Neni 2

#### Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi dhe vendosja e ndërveprimit të përbashkët dhe ndërsjellët midis Palëve dhe përcaktimi i vazhdimësisë së këtij bashkëpunimi që nga periudha e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje deri në përfundimin e saj, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e ndërsjella në kuadër të konsolidimit të gasjeve të integruara për të kthyerit nga zonat e konfliktit, i cili ka si qëllim kryesor përmirësimin e kapaciteteve që lidhen me rehabilitimin dhe reintegrimit të të dënuarve për vepra penale të terrorizmit.

Shërbimi i Proves në Republikën e Shqipërisë dhe IANS pranojnë rëndësinë e komunikimit aktiv, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet tyre për zbatimin e aktiviteteve të projektit në fjalë dhe iniciativave të përbashkëta, për të menaxhuar zbatimin e suksesshëm të projektit dhe arritjen e rezultateve dhe objektivave specifike të tij.

### Neni 3

#### Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin 79/2020 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", në ligjin nr. 78/2020 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Proves", në VKM nr. 421 datë 08.07.2021 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Proves".

#### Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Sherbimit të Proves

##### Neni 4

1. DPSHP bashkërendon punën koordinuese për të zbatuar aktivitetet e projektit përmes vendosjes së pikave të kontaktit në lidhje me menaxhimin e vendimeve alternative dhe masave shtrenjëse nga personave të kthyer nga zonat e konfliktit;
2. Koordinon me IANS në realizimin dhe zhvillimin e mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira për zbatimin e planit aktual të veprimit dhe strategjive të tjera ndër sektoriale të përcaktuara në vendimet gjyqësore.
3. Bashkëpunon me IANS në mirëbesim për të zbatuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit;
4. Siguron dhe zbatojë kushtet e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje;
5. Mbështet dhe ndërmjetëson kur është e nevojshme me përtaqësues të institucioneve të tjera për zbatimin me sukses të aktiviteteve të kësaj Marrëveshjeje;
6. Bashkëpunon dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet që parashikon Marrëveshja si dhe të dakordësojë në lidhje me aspekte të caktuara të organizimit të tyre;
7. Cakton një person kontakti për komunikimin me IANS, i/e cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
8. Mban kontakte të vazhdueshme me personin e kontaktit të caktuar nga IANS lidhur me mbarëvajtjen e projektit.

#### Detyrimet e Institutit për Aktivizëm dhe Ndryshim Social

##### Neni 5

1. Mbështet DPSHP për mbarëvajtjen, efektivitetin dhe cilësinë e aktiviteteve sipas përcaktimeve në projekt;
2. Bashkërendon me DPSHP procesin koordinues dhe zbatues për përmirësimin e objektivave të përmendura në programin e projektit;
3. Bashkëpunon me DPSHP në promovimin e ndryshimeve ligjore dhe administrative për qasjet dhe rolin e shumtë agjencive të aktorëve të ndryshëm në proceset e rehabilitimit dhe rinteprimit të të denuarve për veprat penale që lidhen me terrorizmin.
4. Bashkëpunon me Sherbimin e Proves me qëllim zhvillimin dhe mirëmbajtjen një përmblendje të burimeve të brendshme dhe kërkimore, duke përfshirë një rishikim gjithëpërfshirës në zyrë të të gjitha produkteve të kërkimit dhe njohurive të prodhuara nga PVE.
5. Angazhohet me studues dhe eksperte kombëtare të caktuar nga koordinatori teknik për të zhvilluar prezantime.
6. Bashkëpunon me DPSHP në mirëbesim për të zbatuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit;
7. Siguron dhe zbatojë kushtet e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje;
8. Cakton një person kontakti për komunikimin me DPSHP dhe institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e projektit, i/e cili do të angazhohet drejtpërdrejtë dhe do të jetë si pikë kontakti në komunikimet ndërmjet palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

## Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit

### Neni 6

Palët të mbështetura në partimet bazë, do të mbajnë të informuar njëri-tjetrin dhe do të konsultohen për gëshje me interes të përbashkët, të cilat sipas mendimit të tyre ka të ngjarë të gojnë në bashkëpunim të ndërsjellët.

Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve sipas këtij neni do të jetë duke ruajtur karakterin konfidencial dhe të kufizuar të informacionit dhe dokumenteve të caktuara.

Palët në kohë të ndryshme sipas nevojës, do të kërkojnë për t'u mbledhur për të shqyrtuar dhe diskutuar mbarëvajtjen e aktiviteteve të zhvilluara sipas kësaj Marrëveshje dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.

### Neni 7

#### Personat e kontaktit

Secila nga palët përcakton nga një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura. Në rast të zëvendësimit të personit të kontaktit palët njoftojnë me shkrim njëri-tjetër duke përcjellë informacionin përkatës. Të dhënat e personave të kontaktit parashikohen në Aneksin 2 bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje.

### Neni 8

#### Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcaktohet në bashkëpunim me Palët, si një marrëveshje pa afat por me hapësirë amendimi në rast të shtimit të objektivave të synuar apo në përputhje me dokumentin strategjik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 9

#### Zbatimi i marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, duke qenë partnerë në zbatimin e saj dhe duke punuar së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të parashikuara.

Takime periodike do të realizohen midis stafve përgjegjës dhe personave të kontaktit të DPSHP-së dhe IANS në lidhje me ecurinë dhe arritjen e objektivave të projektit.

Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

### Neni 10

#### Përfundimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje detron Palët të respektojnë qëllimet e përcaktuara në nenet e mësipërme sipas kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Secila nga palët mund të tërhiqet nga angazhimet e marra përsipër dhe të ndërpresë bashkëpunimin kur:

- Me pëlqimin e ndërsjellët,
- Me përmbylljen e programeve
- Me ndryshimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje;
- Konstatohen shkelje të angazhimeve të marra përsipër;

Secila nga palet duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit në rastet kur vendoset tërheqja përpara përfundimit të aratit të kohëzgjatës.

**Neni 11**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Kjo Marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konfliktit gjyqësor që mund të lindë mes Palëve, do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet Palëve, deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.

**Neni 12**

**Dispozita të fundit**

Palët lidhin këtë marrëveshje me qëllim respektimin e të gjitha dispozitave bazuar në parime të integritetit, pavarësisë dhe lirisë nga kritika e njëanshme për bashkëpunimin e Palëve gjatë periudhës së zbatimit të programit të projektit.

Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e ndonjëres prej Palëve për të punuar në mënyrë të pavarur me organizata/institucione të tjera, për të vënë në zbatim programet, projektet apo politikat e saj, sipas veprimtarisë së secilës Palë.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët pas dhënies së pëlqimit reciprok.

**Hyrja në fuqi**

**Neni 13**

Kjo marrëveshje është e zbatueshme në katër (4) kopje origjinale; çdo Palë mban 1 (një) origjinal dhe një dublikatë. Ky memorandum hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy Palët.

**PALET NËN SHKRITJE:**



*[Handwritten signature]*

**Erinda BLLACA NDRQI**

Drejtor Ekzekutiv  
Instituti për Aktivizim dhe Ndryshim Social



**Klervis QOSE**

Drejtor i Përgjithshëm  
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

- Mbështetja e DPSHP në promovimin e ndryshimeve ligjore dhe administrative për qasjet dhe rolin e shumtë agjencive të aktorëve të ndryshëm në proceset e rehabilitimit dhe rinteprimit të dënuarve për vepra penale të terrorizmit.

**Titulli i Projektit**

- Mbështetja e DPSHP, ministrive të linjës dhe institucioneve respektive të drejtim të forcimit të njohurive dhe kapaciteteve për zhvillimin dhe përdorimin e komunikimit strategjik për parandalimin dhe kundërvënien e propagandës së ekstremizmit të dhunshëm.
- Mbështetja e DPSHP për të forcuar koordinimin me ministritë e linjës dhe institucionet respektive për t'u angazhuar së bashku në promovimin e ndryshimeve ligjore që lidhen me proceset e rehabilitimit dhe rinteprimit të burgosurve të dënuar terroristë.

**Qëllimi kryesor i Projektit**

- Përfutjesi kryesor dhe i drejtpërdrejtë i aktiviteteve të projektit është DPSHP dhe stafi i saj, si dhe ministritë e linjës (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).
- Përfutjes të tjere përfshijnë pikat e kontaktit për arsimin, kujdesin shëndetësor dhe social, policimin në komunitet, sistemin penitenciar, si dhe departamentet për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median të ministrive të linjës që janë përgjegjëse për komunikimin me publikun.

**Objektivat specifike**

- Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve do të përbëhet nga aktivitetet, të cilat synojnë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e punonjësve të përfshirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, veçanërisht në zhvillimin e ofrimit të komunikimeve për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEEDH).
- Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve do të përbëhet nga aktivitetet, të cilat synojnë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e punonjësve të përfshirë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, veçanërisht në zhvillimin e ofrimit të komunikimeve për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEEDH).

**Përfutjesit**

- Njohuri dhe ekspertizë e përmirësuar për zhvillimin e kapaciteteve njerezore dhe institucionale si dhe nderveprimi me aktore të tjere që menaxhojnë rastet e te kthyerve përmes programeve rehabilituese dhe rintepruese .
- Praktika të konsoliduara ligjore për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm nga DPSHP, ministritë e linjës dhe institucionet respektive të përfshira në vijën e parë.
- Njohuri të përmirësuar mbi nevojat e kapaciteteve për të përhapur në mënyrë efektive mesazhe dhe komunikime për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEEDH).

**Plani i Aktiviteteve**

- Njohuri të përmirësuar mbi nevojat e kapaciteteve për të përhapur në mënyrë efektive mesazhe dhe komunikime për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEEDH).
- Praktika të konsoliduara ligjore për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm nga DPSHP, ministritë e linjës dhe institucionet respektive të përfshira në vijën e parë.
- Njohuri të përmirësuar mbi nevojat e kapaciteteve për të përhapur në mënyrë efektive mesazhe dhe komunikime për qëllime që lidhen me parandalimin/kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm (P/KEEDH).

**Rezultatet e pritshme**